



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i životne sredine
Ministry of Economy and Environment

RAPORTI I PROGRESIT PËR VITIN 2019

I

**PROGRAMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ENERGJISË
2018-2020**

Prishtinë, Qershor 2020

Përmbajtja

Shkurtesat	3
I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	5
II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE	8
III. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE	22
IV. SHTOJCA - PJESA MATRICORE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2018 TË PZSE 2018-2020	24

Shkurtesat

ACER	Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë
AKEE	Agjencioni i Kosovës për Efiçencë të Energjisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
EC	Komisioni Evropian
EE	Efiçenca e Energjisë
EnCS	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike
ESCO	Kompanitë e Shërbimit të Energjisë
EU	Unioni Evropian
FIEK	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
HC	Hidrocentrale
HCV	Hidrocentrale të vogla
IDA	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para Anëtarësimit
KDP	Komiteti Drejtues i Projektit
KE	Komisioni Evropian
KEDS	Ndërmarrja e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESCO	Ndërmarrja e Furnizimit të Energjisë Elektrike
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Banka Gjermane për Zhvillim)
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
kV	Kilovolt
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MCC	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
MEPTINIS	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
MeD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MW	Megavat
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NOx	Oksidi i Azotit
NQ	Ngrohtorja e Qytetit
NTCKR	Nën komiteti për Termocentralin Kosova e Re

NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
NJIP	Njësia për Implementimin e Projektit
OS	Operatori i Sistemit
OSS	One Stop Shop
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OST	Operatori i Sistemit të Tregut
OT	Operatori i Tregut
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PKVEE	Plani Kombëtar i veprimit për Eficiencë të Energjisë
PZSE	Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë
QK	Qeveria e Kosovës
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SNS/FDIL	Skema e Ndihmave Sociale/Familjet e Dëshmoreve dhe Invalidëve të Luftës
TC	Termocentral
TeR	Termet e Referencës
TIKA	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim
TM/TU	Tensioni i mesëm/Tensioni i ulët
UA	Udhëzimi Administrativ
UP	Universiteti Prishtinës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
USEA	Asociacioni për Energji i Shteteve të Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë të Kosovës është detyrë ligjore dhe prioritare për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Bazuar në Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081, Nenin 7, ish MZHE ka hartuar Programin për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë të Kosovës (PZSEK) për periudhën 2018-2020, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në korrik të vitit 2018. Në vazhdimësi të përmbushjes së kërkesave ligjore, ish MZHE (Ministria) në vitin 2019, ka përgatitur raportin vjetor mbi progresin në realizimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë për vitin 2018, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë, të cilin e ka dërguar në Qeveri. Ky obligim ligjor është plotësuar edhe në vitin 2020, me që rast Ministria ka përgatitur raportin vjetor mbi progresin në realizimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë për vitin 2019.

Raporti i Progresit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, për vitin 2019, është përgatitur bazuar në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020. Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet e detajuara për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026.

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020, paraqet një listë prej 27 objektivash specifike dhe 97 aktiviteteve që parashihet të ndërmerren për arritjen e 5 objektivave strategjike për zhvillimin e sektorit të energjisë deri në vitin 2020.

Qëllimi i këtij raporti të progresit është që të evidentohet ecuria e zbatimit e projekteve të përcaktuara në PZSE për vitin 2019 si dhe të evidentohen sfidat dhe të propozohen zgjidhjet për vendimmarrje nga autoritetet përkatëse.

Ish MZHE-ja ka marrë masat dhe ka bashkëpunuar me të gjithë aktorët kryesorë, me synim të vendosjes së një bashkëpunimi institucional të frytshëm, në mbështetje të realizimit, me sa më pak probleme të masave të parashikuara në PZSE 2008-2020. Një bashkëpunim i mirë është vendosur me të gjitha institucionet relevante, por ende duhet të punohet që ky bashkëpunim të ngritët në një nivel më të lartë.

Në këtë Raport të progresi janë përfshirë të gjitha projektet të cilat kanë filluar para vitit 2019 e që kanë vazhduar gjatë vitit 2019 dhe që vazhdojnë edhe për gjatë viteve të ardhshme, si dhe projektet të cilat kanë filluar dhe përfunduar brenda vitit 2019.

Disa nga projektet kyçe që janë paraparë të zhvillohen, sipas PZSE 2018-2020, gjatë viti 2019 janë përmbushur në tërësi, në disa prej tyre kanë pasur progres të theksuar dhe vazhdojnë të realizohen gjatë vitit 2020 sipas planifikimeve, ndërsa në një numër më të vogël ka pasur vonesa të vogla në proces të realizimit. Progresi për secilin objektiv paraqitet sipas 5 objektivave strategjike të përcaktuar në Strategjinë e Energjisë 2017-2026.

Në vazhdim janë paraqitur projektet më të rëndësishme të sektorit të energjisë, të cilat janë realizuar apo ka pasur ngecje gjatë vitit 2019.

- TC Kosova e Re - Është përzgjedhur ofertuesi i preferuar për kontratën Inxhiniering, Prokurim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje Afatgjatë. Po ashtu, të dy palët Qeveria e Kosovë dhe organizatat e saja si dhe investitori ContourGlobal kanë adresuar shumicën e kushteve paraprake siç janë të identifikuar në marrëveshjet komerciale.

Zhvillimi projektit TC “Kosova e Re”, nuk është realizuar sipas afateve të parapara në PZSE 2018-2020;¹

- Remonti kapital i Njësisë A3 të TC Kosova A, ka përfunduar;
- Remonti kapital i Njësisë B2 të TC Kosova B, ka përfunduar;
- Plani i detajuar për hapjen e Mihjes së re “Sibivci Jugor”, ka përfunduar;
- Në rrjetin e Shpërndarjes janë realizuar investime duke përfshirë njehsorë inteligjente me komunikim GSM GPRS, njehsore inletigjent PLC, njehsorë gjysëm-indirekt dhe njehsorë për kyçje të reja. Nga realizimi edhe i aktiviteteve tjera të parapara në rrjetin e shpërndarjes kanë përfituar më shumë se 39,487 konsumatorë, të cilët do të ndikohen nga konvertimi 20 kV Conversion dhe projektet e Master-Planit gjatë vitit 2019. Po ashtu nga investimet e bëra në rrjetin e TU kanë përfituar 13,343 konsumator në përmirësim të rrjetit.
- Është duke u punuar në zhvillimin e programeve dhe praktikave të reja mësimore, në ngritjen e kapaciteteve dhe përfshirjen e kuadrove të reja në zhvillimet e sektorit të energjisë në kuadër të reformave programore universitare në shkencat teknike të fushë-veprimtarisë së energjisë;
- Programi i mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë ka vazhduar sikurse në vitet e kaluara dhe shuma totale e subvencionimit në 2019 ka qenë 4,500,000.00 euro;
- Aktivitetet e parapara për zbatimin e “masave të buta” sipas udhërrëfyesit të SKE-së, pothuajse janë plotësuar apo janë në përfundim për të gjitha masat që nuk janë të kushtëzuara me progresin në zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë me Serbinë;
- KOSTT është certifikuar nga ZRRE dhe tashmë operon si Operator Sistemi dhe Tregu i Certifikuar, pas opinionit pozitiv nga SKE;
- Kanë vazhduar aktivitetet e grupeve të përbashkëta punuese për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri. Janë identifikuar dallimet në çështjet që kanë të bëjnë me Licencat dhe Legjislacionin;
- Grupi Regjional i Evropës Kontinentale - trup i ENTSO-E, kanë votuar për propozimin e ndryshimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT-ENTSO-E për zhbllokimin e procesit dhe bërjen e KOSTT-it te operoje si Zonë/Bllok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale dhe ka vendosur afat që kjo të ndodhë jo më larg se Prill 2020;
- Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka nxjerr vendim për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe te strukturës së pronësisë së kapitalit të bursës së energjisë elektrike (ALPX). Me këtë vendim themelohet Bursa shqiptare (ALPX), pjesë e së cilës do të jetë edhe

¹ Kompania e kontraktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, ContourGlobal, në mars të 2020, ka njoftuar se ka pezulluar planet për të vazhduar më tej me projektin

Kosova;

- Zgjerimi dhe rahabilitimi i rrjetit të Ngrohtores Termokos, ka vazhduar në lagjen Kalabria. Janë instaluar 23 nënstacione të reja (rreth 1300 konsumatorë të rinjë, me përafersisht 150 000 m² sipërfaqe). Po ashtu është përfunduar edhe pjesën e mbetur nga viti i kaluar i segmentit Termokos - Iber Lepenc, ku është bërë ndërrimi i gypave, DN600 me gjatësi të trasesë 275m;
- Në fund të vitit 2019, është hedhur gurëthemeli i fillimit të punimeve për ndërtimin e impianitit të centralit të kogjenerimit në Gjakovë;
- Kanë përfunduar projektet e zbatimit të masave të EE-së në nivel lokal në 26 objekte të shërbimit publik, të financuara nga BK;
- Janë ybatuar masat e efijencës së energjisë në ndërtesat e shërbimit publik në 19 objekte shkollore;
- Është realizuar projekti Fushata promovuese për Efijencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Është finalizuar rregullorja për Organizmin dhe Sistematizimin e vendeve të punës së Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë;
- Është hartuar drafti i Planit Kombëtar i Veprimt për Efijencë të Energjisë PKVEE IV 2019-202 dhe është i gatëshëm për aprovim në Qeveri;
- Është hartuar Drafti i Strategjisë për Renovimin e Ndërtesave Publike dhe pritjet të kalojë në procedurat ligjore administrative për aprovim;
- Përmes investimeve private janë realizuar disa projekte nga BRE – të, të cilat ndikojnë në plotësimin e caqeve të energjisë nga BRE-të:

Hidocentrale	7 Projekte, 29.76 MW
Turbina nga Era	1 Projekt, 32.4 MW
Panele solare	2 Projekte, 3.4 MW
- Projekti i Dekomisionimit dhe çmontimit të objekteve të gazifikimit, azotikut, ngruhtores dhe objekteve tjera që nuk e pengojnë operimin normal të njësive aktive të TC “Kosova A” është duke u realizuar sipas Termave të Referencës nga kompania konsulente Sweco GmbH, e cila ka filluar punën në muajin korrik 2018 dhe pritjet të përfundoj në muajin gusht 2020.

II. PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Raporti i Progresit përfshinë disa nën-sektorë. Në këtë raport paraqitet gjendja e projekteve dhe aktiviteteve për gjatë vitit 2019 edhe në mënyrë tabelare-matricore (Shtojca).

Për përgatitjen e këtij raporti të progresit, ish MZHE ka dërguar formën matricore të raportimit të të gjitha akterët relevantë të sektorit të energjisë, për të raportuar për progresin e arritur, sfidat dhe problematikat në zbatimin e projekteve gjatë vitit 2019. Pas marrjes së inputeve nga akterët është përpunuar edhe më tutje matrica dhe është finalizuar.

Bazuar në pjesën matricore të Raportit të Progresit për vitin 2019, është përgatitur pjesa narrative e këtij raporti.

Pjesa narrative e bënë përshkrimin e progresit të secilit objektiv strategjik, respektivisht objektiv specifik, ku përshkruhet progresi i arritur, arsyeja e vonesave të disa aktiviteteve/projekteve si dhe sfidat për disa projekte, të cilat nuk janë realizuar në tërësi.

Përshkrimi i mëposhtëm është bazuar në strukturën e PZSE 2018-2020, por nuk janë përfshirë objektivat specifike të cilët janë realizuar në vitin 2018 dhe ata të cilët janë planifikuar të fillojnë në vitin 2020.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SIGURIMI I FURNIZIMIT TË QËNDRUESHËM DHE CILËSOR ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE ME KAPACITETET TË NEVOJSHME PËR NJË SISTEM STABIL ELEKTROENERGJETIK

Objektivi specifik 1.1: Termocentrali TC “Kosova e Re”²

Përmbyllja financiare e projektit TC “Kosova e Re” - Nuk është përfunduar.

Sfidë mbetet përmbyllja e të gjitha kushteve paraprake siç janë përcaktuar në marrëveshjet komerciale dhe që janë kushte të pashmangshme për arritjen e përmbylljes financiare. Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës kanë shkaktuar pengesa në përmbushjen e obligimeve dhe në vendimarrje nga ana e KDP.

Kontraktimi i Inxhinierit të Pavarur - Qeveria përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ka shpallur thirrjen për oferta për kompanitë e interesuara. Është përfunduar faza e parë e tenderimit dhe janë parakualifikuar 3 kompani. Procesi është në fazën e vlerësimit të ofertave. Mbetet i hapur plotësimi i komisionit vlerësues në mënyrë që të përfundohet vlerësimi.

Plotësimi me staf përkatës i njësive Implementuese të Projektit sipas vendimit të KDP-së - Nuk ka progres sa i përketë kesaj çështjeje.

Realizimi i konferencës me temën “Investimet strategjike në sektorin e energjisë – Mundësitë e përfshirjes dhe participimi aktiv i NVM-ve në këto projekte” - Duke pasur parasysh zhvillimet në lidhje me projektin TC Kosovës së Re, ky aktivitet nuk është realizuar.

² Në mars 2020 Kompania Contor Global ka deklaruar publikisht tërheqjen nga zhvillimi i mëtejshëm i procesit të ndërtimit të Projektit. Kjo paraqet një sitatë të re dhe sfidë për sektorin e energjisë elektrike sa i përket furnizimit afatgjatë me energji elektrike. Aktivitetet e listuara I perkasin periudhes se vitt 2019.

Objektivi specifik 1.2: Realizimi i remonteve kapitale në TC “Kosova A”, TC “Kosova B” dhe instalimi i elektro-filtrave në TC “Kosova B”

Remonti Kapital i njësisë A3 të TC Kosova A - Është realizuar gjatë periudhës, 08.04.2019, deri me 15.08.2019.

Remonti kapital i njësisë B2 të TC Kosova B - Është realizuar gjatë periudhës, 16.04.2019, deri me 26.08.2019.

Objektivi specifik 1.3: Mihja e Re “Sibovci Jugor”

Përgatitja e planit të detajuar për hapjen e Mihjes së re - Operatori Ekonomik MIBRAG me datë 06.06.2019, e ka finalizuar dhe dorëzuar në KEK sh.a, raportin final të Planit të detajuar dhe investiv për hapjen Mihja e Re.

Hapja e mihjes së re - KEK-u në qershor 2019 ka shpallur tenderin për sigurimin e dy eskavatorëve, i cili është në proces.

Sfidë – Vlera e investimeve të nevojshme për hapjen e Mihjes së Re është e madhe dhe nuk mund të realizohet pa përkrahjen e Qeverisë së Kosovës. Sipas dokumentit plani i detajuar dhe investiv për minierën e re investimet e nevojshme janë 380 milion euro (295 milion euro në 5 vitet e para).

Objektivi specifik 1.4: Reduktimi i humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes (reduktimi i humbjeve teknike deri në 9.5% deri në vitin 2026 në rrjetin e shpërndarjes)

Projektet e përcaktuara në PZSE 2018-2020 kanë pësuar ndryshime, gjatë procesit të konsultimit publik për shqyrtimin e dytë periodik për periudhën rregullative 2018-2022 dhe e cila është paraparë edhe në PZSE 2018-2020 (shih shënimin 2 dhe 3 në PZSE 2018-2020 faqe 14). Plani i investimeve të KEDS-it për vitin 2018 ka paraparë investimet në total në vlerë prej 20.248 milion euro.³

Për aktivitetet që kanë të bëjnë me: Ndërrimin e njësoreve mekanik me njehsorë digjital; Zhvendosjen e njehsorëve (MMO); Implementimin e njehsorëve automatik inteligjent, janë realizuar këto investime:

- 2,922 njehsorë inteligjente me komunikim GSM GPRS;
- 1,8078 njehsore inletigjent PLC;
- 196 njehsorë gjysëm-indirekt;
- 10,039 njehsorë mekanikë janë zëvendësuar me ata elektronik;
- 25,972 njehsorë janë vendosur për kyçje të reja.

Për aktivitetet që kanë të bëjnë me: Rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes duke u fokusuar në kalimin në nivel të tensionit 20 kV, respektivisht eliminimin gradual të tensionit 35 kV dhe 10 kV, në përputhshmëri me rregullat e ZRRE-së dhe standardet ndërkombëtare; Zvogëlimin e linjave të gjata radiale duke vendosur stabilimente shpërndarëse nëpër degëzime të daljeve 10kV, janë realizuar këto investime në zonat më kritike si Ferizaji, Fushë Kosova dhe Dragashi për të zgjidhur problemet e rritjes së shpejtë të konsumit, mbingarkesës së rrjetit dhe përmirësimit të parametrave të tjerë teknik. Materialet e vendosura për këto projekte janë: 13 transofrmatorë, 21 kthina, 18,000

³ ZRRE me 24 shtator 2019 aprovoi planin 5 vjeçar zhvillimor dhe investues për KEDS për periudhën 2018-2022. Pasiqë parametrat rregullativ për periudhën e dytë rregullative u aprovuan shumë më të ulëta se ato të pritura nga KEDS, KEDS planifikon të investojë 21.9 milion euro në vitin 2019, duke zvogëluar buxhetin e aprovuar të investimeve nga investimet që nuk nderlidhen me rrjetin siç janë automjetet, objektet apo TI. Buxheti për investimet në rrjet (Master plani, konvertimi 20 kV, projektet e perforcimit, njehsorët dhe SCADA) do të mundohet të mbetet i pandryshuar.

Investimet e KEDS-it të realizuara deri në fund të 2019 janë në përputhje me strategjinë e KEDS-it dhe madje kanë tejkaluar pritshmeritë fillestare, duke u përmblyllur kishte në 22.1 milion investime të realizuara nga 21.9 sa ishin planifikuar fillimisht.

m përçus, 35,320 m kablo, koka kablloviqe 267 copë, 10 shtylla etj. Në projektin e Fushë-Kosovës është përfshirë edhe renovimi i nën-stacioneve ekzistuese dhe ndërtimi i një nënstacioni të ri.

Për aktivitetet që kanë të bëjnë me: Ndërtimi i nënstacioneve të reja të rrjetit të TM/TU; Ndërtimi i rrjetit të ri të tensionit të ultë; Rehabilitimi i rrjetit ekzistues; Furnizimi alternativ i daljeve 10kV, gjegjësisht nënstacioneve ekzistuese nga ana sekondare; përfshijnë këto investime:

Transformatorë të rinj në zonat e nevojshme për investime, Zëvendësimi i transformatorëve ekzistues me ata të ri për rritjen e kapacitetit, Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët, Përforsimi i rrjetit të tensionit të mesëm brenda fushëveprimit të projekteve të TU, në përputhje me planet e ardhshme të daljeve të TM, Zgjerimi i rrjetit të TM për kyçjen e transformatorëve të ri, Vendosja e MMO-ve (lëvizja e njehsorëve jashtë në shtyllë ose në ormana tokësorë të njehsorëve), etj.

Më poshtë do të paraqesim materialet e përdorura për këto realizimin e projekteve:

- Janë vendosur 48 transformatorë dhe 48 panele të TU;
- Janë vendosur 461 shtylla, 272 kuti të njehsorëve dhe 21,408 m kablo (linja);
- Janë vendosur 45 transformatorë, 73 panele të TU, shtylla 6,595 copë, kuti të njehsorëve; 8,298, rreth 900,000 m kablo, respektivisht 388,439 m kablo nëntokësore dhe 508,996 m kablo mbitokësore, etj.

Në lidhje me projektin Implementimi i sistemit SCADA për kontrollin, komunikimin dhe mbikëqyrjen e të dhënave, ky projekt është implementuar sipas planifikimeve dhe pritet që të përfundojë faza III dhe faza e fundit e projektit Scada deri në fund të vitit 2020.

Objekti i specifik 1.5: Reforma Programore Universitare në shkencat teknike të fushën e energjisë

Zhvillimi i programeve dhe praktikave të reja mësimore, konform kërkesave të reja të tregut të punës për inxhinierët e rinj, bazuar në modelet më të mira në vendet e BE-së - FIM e ka të akredituar Programin studimor "Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtërishme" deri me 30.09.2021, i cili është bazuar në praktikën më të mirë të BE-së dhe nevojave të tregut të punës në Kosovës. Në FIEK janë përpiluar Programet e reja për drejtimin e Elektroenergjetikës për nivelin Bachelor dhe Master në përputhje të plotë me kërkesat e reja të tregut të punës. Gjithashtu është përpiluar Programi i ri i doktoratës, si program i përbashkët për të gjitha drejtimet e FIEK, ku përfshihet edhe Drejtimi i Elektroenergjetikës.

Sfidë - Mungesa e literaturës adekuate në gjuhën shqipe për nivelin bachelor si dhe mungesa e stafit akademik (profesorëve dhe asistentëve). Tejkalmi i këtyre sfidave mund të arrihet me angazhimin e stafit të rregullt, pra rritjen e numrit të stafit akademik në drejtimin e Elektroenergjetikës, si dhe me krijimin e mundësive që ky staf të trajnohet dhe të vizitohet qendrat, institutet dhe Universitetet e rëndësishme që kanë drejtimin e elektroenergjetikës.

Mbështetja me bursa për studentët e dalluar që ndjekin studime në ato programe në Fakultetin i inxhinierës Elektrike dhe kompjuterike - drejtimi i Elektronergjetikes: niveli Bachelor, Master dhe Doktoratur - Nuk ka pasur mbështetje financiare për bursa për studentët.

Përkrahja në kompletimin e laboratorit në fushën e Termoenergjetikës dhe Energjisë së Ripërtërishme

FIM - ka bërë përpjekje për gjetjen e fondeve për kompletimin e laboratorëve të Energjisë Termike dhe të Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme (BRE), por nuk ka ndonjë rezultat konkret.

Komuna e Prishtinës e ka përkrahur projektin e FIM-it me instalimin e 8 trupave ndriçues hibrid me energji të erës/diellit. Në objektin e Laboratorëve nga FIM-i është ngritur një Laborator i BRE-ve, ku janë të vendosura një Hidro Turbinë për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, 1 turbinë e erës me aks vertikal, 1 turbinë e erës me aks horizontal, 1 sistem solar me aks fiks dhe 1 sistem solar për përcjelljen e diellit. Janë hartuar projektet për ngritjen e një Centrali elektrik PV me fuqi 2 x 100 [kWh] në kulmin e laboratorëve të Fakulteteve Teknike.

Laboratorët e Fakulteteve Teknike janë në proces të përfundimit të projektit të Eficientë s Energjetike të financuar nga Banka Botërore dhe të realizuar nga Mistria e Zhvillimit Energjetik. Në kuadër të këtij projekti janë të parapara: izolimi i jashtëm i objektit, ndërrimi i dritareve dhe dyerve, ndërrimi i trupave ndriçues me trupa eficientë dhe rehabilitimi i sistemit të ngrohjes.

FIEK - Pajisjet e sjellura në laboratorët e Elektroenergjetikës janë:

- "Primary Injection Test equipment up to 2,500A., with auxiliary ac and dc outputs" me të gjitha pajisjet përcjellëse;

- "Transmission line model 150km/300km (93.2miles/186.4miles)" me të gjitha pajisjet përcjellëse;

- "Double busbar unit, three-phase, incoming / outgoing feeder", me të gjitha pajisjet përcjellëse.

Sfidë - Sigurimi i fondeve për kompletimin e laboratorëve me qellim të përgatitjes sa më të mirë të studenteve për tregun e punës në Sektorin e Energjisë.

Objektivi specifik 1.6: Programi i Mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë

Në fillim të muajit mars 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Kompaninë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS-SH.A) dhe Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KESCO-SH.A), për subvencionimin e energjisë së shpenzuar elektrike (deri në 300 KWh) për përfituesit e Skemës së Ndhmës Sociale (SNS), Skemës së Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës (FDIL), Skemës për Personat e Verbër (SPV) dhe Skemës për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik (SPPT) për vitin 2018. Buxheti i ndarë për vitin 2018 është 4,500,000.00 euro. Pas përfundimit të procesit të ankimimit, nga kjo marrëveshje kanë përfituar 3.304 familje nga SNS, 10.442 familje nga FDIL, 836 persona nga SPV dhe 1.269 persona nga SPPT. Në total janë subvencionuar 35.851 familje/individë. Shuma totale e mjeteve të shpenzuara është 4,500,000.00 euro. Pra, janë shpenzuar të gjitha mjetete e parapara për subvencionimin e energjisë elektrike për përfituesit e skemave të lartëcekura.

Objektivi specifik 1.7: Trajtimi i komuniteteve të prekura nga aktivitetet energjetike

Projekte direkte për komunitetin, të cilat aporovohen nga Kuvendi Komunal i Obiliqit – Është realizuar parku në qytetin e Obiliqit. Po ashtu janë ndërtuar edhe dy terene sportive një në qytetin e Obiliqit dhe një në fshatin Dardhishtë.

Realizimi i projekteve zhvillimore për komunitetin nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit nga investitori TC Kosova e Re (Investimet për komunitetin për vitet 2019- 2020, 2 mil. €) - Eshtë kompletuar Bordi i Fondit për Zhvillimin e Komunitetit. Qeveria e Kosovës ka deleguar pjestarët e saj në përputhje me marreveshjet komerciale.

SFID - Fillimi dhe sukcesi i punës së këtij Fondi do të varet nga arritja e përmbylljes financiare të projektit TC Kosova e Re.

Objektivi specifik 1.8. Studimi gjithë përfshirës për një periudhë deri në 2050 për sektorin e energjisë

Në këtë fazë raportuese nuk ka pasur ndonjë aktivitet, sepse donatorët janë tërhequr nga mbështetja financiare për realizimin e këtij studimi.

Në KASH 2020-2022, është planifikuar që realizimi i këtij studimi të bëhet në vitet 2021-2022. Burimi i financimit: BRK (0.25 mil €) dhe Komisioni Evropian (1.25 mil €).

Për PZSE 2018-2020, në lidhje me këtë studim nuk do të ketë ndonjë aktivitet.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: INTEGRIMI NË TREGUN RAJONAL TË ENERGISË

Objektivi specifik 2.1: Zbatimi i “masave të buta” sipas udhërrëfyesit të SKE-së

Aplikimi për anëtarësim / Anëtarësimi i ZRrE në ACER - Me 29.11.2019, ZRRE i ka dërguar shkresë/kërkesë drejtorit të SKE z. Kopac që ta përkrah ZRRE-në për anëtarësimin në ACER. Tani i mbetet SKE dhe ACER të njoftojnë ZRRE-në për pranimin e anëtarësimit si vëzhgues.

Sigurimi i likuiditetit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike me masa të përshtatshme rregullatore siç janë rishikimet e kontratave, shkarkimet e kapaciteteve, impiantet virtuale të energjisë etj. - ZRRE ka ndërmarr të gjitha veprimet që janë në mandatin e saj për krijimin/hapjen e tregut konkurrues të energjisë.

Gjate vitit 2019, KEK për tepricat e energjisë pas kryerjes së obligimeve që dalin nga Bulk Supply Agreement (BSA), si dhe HC Ujmani tërë sasin e prodhuar kanë filluar që shitjen ta bëjnë duke respektuar procedurën e prokurimit të energjise elektrike.

Sipas "Udhëzuesit për liberalizimin e tregut" konsumatorët në nivelin 35 kV dhe 10 kV ishte paraparë që deri me 31 mars 2019 do ti nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike, por ky afatë është ndryshuar duke u shtyer për 31 mars 2020.

Sfidë paraqitet krijimi i kushteve të favorshme për hyrje të furnizuesve të rinjë në treg, kjo për shkak se:

- KOSTT ende nuk është anëtarësuar në ENTSO-E
- "Bulk Supply Agreement" mes KEK dhe KEDS/KESCO.

Prezantimi i një procesi të koordinuar të llogaritjes së kapacitetit për alokimin e kapaciteteve një ditë-para (day ahead) bazuar në një parashikim i koordinuar të kongjestionit - Kjo do të realizohet kur KOSTT të filloj të operoj si zonë rregulluese. Planifikohet të bëhet deri me TM2 2020.

KOSTT dhe OST e Shqipërisë janë në proces të krijimit të një blloku të përbashkët të LFC. Në Dhjetor 2019 është nënshkruar Marrëveshja ndërmjet KOSTT dhe OST-it të Shqipërisë për krijimin dhe operimin të një LFC blloku të përbashkët. Marrëveshja i është prezantuar edhe RG CE (ENTSO-E) e cila si e tillë është mirëpritur. Kjo marrëveshje për krijimin e bllokut të përbashkët, ndihmon KOSTT-in në disa aspekte si nga ana operuese si zonë operuese ashtu edhe nga ana teknike dhe ekonomike.

Certifikimi Operatori i Sistemit të Transmisionit në linjë me Paketën e Tretë të Energjisë - KOSTT tashmë operon si Operator sistemi dhe Tregu i Certifikuar nga ZRRE. ME date 15 Shkurt 2019 pas opinionit pozitiv nga SKE, ZRrE ka nxjerrë vendimin final për Certifikionin e KOSTT.

Rritja e efektivitetit të autoriteteve administrative - konkurrenca dhe ndihma shtetërore – Janë rekrutuar pesë zyrtarëve në kuadër të Departamentit të Ndhmës Shtetërore/MF dhe tanimë në Departamenti i Ndhmës Shtetërore përbëhet nga gjithsej 7 anëtar.

Është hartuar Rregullorja për Procedurat e Njoftimit në përputhje me Ligjin për ndihmën shtetërore; Është aprovuar Rregullorja Nr.1/2013 për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

Komisionit të Ndhmës Shtetërore (KNSH) është emëruar me 7 mars 2019 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Krijimi i inventarit fillestar për ndihmën shtetërore është bërë në Qërshor të vitit 2019 dhe është një

proces i vazhdueshëm i përditësimit me skemat dhe vendimet e reja.

Sfida gjatë kësaj periudhe ishte aprovimi i projekt-rregullores De Minimis, e cila nuk është aprovuar gjatë 2019-tës për shkak të Qeverisë në dorëheqje.

Objektivi specifik 2.2: Krijimi i tregut të përbashkët me Shqipërinë si një zonë e përbashkët tregtare energjetike Kosovë – Shqipëri, si hap i parë drejt integritimit në tregun e përbashkët të Komunitetit të Energjisë

Debllokimi i marrëveshjes së Kyçjes së KOSTT me ENTSO-E dhe operimi i KOSTT si Zonë rregulluese në kuadër të ENTSO-E - Më 23.05.2019, në mbledhjen e 52-të të RGCE (Grupi Regjional i Evropës Kontinentale) - trup i ENTSO-E, të gjithë përfaqësuesit e OST (Operatorët e Sistemit Transmetues) të Evropës Kontinentale, (përveç atyre të Greqisë dhe Spanjës, që abstenuan dhe i Serbisë që votoi kundër) votuan për propozimin e ndryshimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT-ENTSO-E për zhbllokimin e procesit dhe bërjen e KOSTT-it të operojë si Zone/Bllok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale dhe kjo jo me larg se Prill 2020. Një draft i Marrëveshjes së Kyçjes është dërguar për komente tek RG CE.⁴

Kyçja e linjës 400 kV Kosovë Shqipëri dhe aktivizimi i kontratës për LFC (rregullim sekondar me Shqipërinë) – Ky aktivitet nuk mund të realizohet derisa KOSTT do të operojë si Zone/Bllok Rregullues i pavarur brenda Evropës Kontinentale dhe si rezultat i kësaj edhe Linja 400kV Kosove - Shqipëri do të funksionalizohet plotësisht.

Aderimi në bursën e shkëmbimeve të energjisë që është në themelimit në Shqipëri - Më 15.05.2019 Këshilli i Ministrave të Shqipërisë të Shqipërisë ka nxjerr një vendim për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të bursës së energjisë elektrike. Me këtë vendim është definuar struktura e aksionarëve apo palëve tjera tregtare sipas pjesëmarrjes së kapitalit. Në mënyrë që të themelohet Bursa shqiptare (ALPX), Këshilli i ministrave ka nxjerrë edhe vendimin për procedurat e përzgjedhjes së aksionareve të kompanisë. Pas përzgjedhjes së aksionareve fillon procesi i krijimit të kompanisë që do të operoj tregjet. Gjatë muajit Mars 2020 pritet që të iniciohet procesi i përzgjedhjes së Aksionarëve të Kompanisë dhe KOSTT do të jetë pjese e kësaj burse. Sipas vlerësimeve tona i tere procesi nga faza e krijimit të kompanisë deri në operim real mund të jetë deri në Q4 të vitit 2021.

Krijimi i një zone të përbashkët tregtare Kosovë-Shqipëri (binding zone) ku linjat aktuale interkonektive do të konsiderohen si linja të brendshme dhe nuk do të alokohen kapacitetet – Është duke u punuar në këtë drejtim dhe ky aktivitet ndërlidhet me aktivitetet e lartëcekura.

Ndërlidhja me tregun rajonal një ditë-para (day ahead) dhe tregut gjatë ditës (intra- day) - Me themelimin e Bursës Shqiptare për Energji parashikohet të bëhet ndërlidhja e saj me Bursat tjera rajonale.

Operacionalizimi i tregut të përbashkët Kosovë Shqipëri

I. Korniza Ligjore - Palët Kosove - Shqipëri (përfaqësuesit e grupit legal) janë në proces të identifikimit të dallimeve në legjislacionin e dy vendeve, përfshirë edhe licencat dhe njohjen e tyre reciproke. Nga takimet e grupeve punuese të mbajtura janë identifikuar çështjet, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me Licencat dhe Legjislacionin e që duhet intervenuar. Në këtë proces është angazhuar edhe konsulencia por edhe akterët tjerë si janë: KOSTT, ish MZHE, përfshirë edhe ZRRE.

II. Rregullatorët dhe licencimi - Janë themeluar tri grupe punuese të përbashkëta Kosovë-Shqipëri (GP për çështje ligjore/rregullative; GP për çështje teknike-operative dhe GP

⁴ Marrëveshja e re e kyçjes është miratuar me 20.04.2020 nga ENTSO-E dhe tani pritet që KOSTT do të operoj si zone rregulluese

për çështje komerciale), aktivitetet që po realizohen sipas dinamikës së paraparë të cilat po udhëhiqen nga koordinoret dhe udhëheqësit e GP nga të dy vendet.

Krijimi i procedurave për alokimin e kostove të kongjencionit zhvillohet pas themelimit të APEX-it (zhvillohen nga kompania që do të themelohet).

III. Modeli i Tregut- Dizajni i Tregut është në pritje të dy projekteve atë të Statusit të TC Kosova e Re dhe APEX-it. ZRRE ka adoptuar dokumentin Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit.

IV. Operimi i Sistemit - Komunikimi realizohet përmes ndërlidhjes telekomunikuese me fije optike dhe protokollin e shkëmbimit të dhënave në mes të dy operatorëve
Krijimi i një Qendre të Përbashkët Dispeçerike për të dy sistemet dhe eventualisht i një qendre regionale, si dhe krijimi i Bllokut të përbashkët Operues i dy zonave Rregulluese KOSTT OST, mbeten opsione për të ardhmen pas operimit të KOSTT si zone Rregulluese.

Disa nga aktivitetet e këtij objekti strategjik/specifik të parapara që të realizohen në vitin 2019, janë të kushtëzuara nga dinamika e krijimit të tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: RRTJA E KAPACITETEVE EKZISTUESE TË SISTEMEVE TERMIKE DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË REJA

Objektivi specifik 3.1: Zgjerimi i rrjetit të Ngrohtores "TERMOKOS", sipas një Master Plani të zgjerimit

Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit me IPA 2015 – Zgjerim i rrjetit me konsumatorë të rinjë: në lagjen Kalabria, ku janë instaluar 23 nënstacione të reja (rreth 1300 konsumatorë të rinjë, me përafersisht 150000 m² sipërfaqe). Po ashtu janë lidhur në rrjetë këta konsumatorë institucional: Qerdhja e femijëve të Qafa, Fakulteti i Arkitekturës, SHMU "Naim Frasheri", Stacionim policor "Hamez Jashari", Ndërtesa e drejtorisë së Doganave të Kosovës.

Janë rehabilituar 50 nënstacione në rrjetin ekzistues (nga 100 të planifikuara).

Janë ndërruar gypa të dimenzioneve të ndryshme, nga DN50 deri DN300 në shumë segmente të planifikuara.

Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit me fonde të KfW - Segmenti (1) Termokos - Ibër Lepenc, është bërë ndërrimi i gypave DN600 në pjesën e trasës së mbetur nga viti i kaluar, në segmentin 21/22 deri 33, me gjatësi të trasës 275m. Lidhur me projektin për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit në vlerë rreth 12 mil €, gjatë vitit 2019, është zgjedhur konsulencia për projekt - "IC Consulente" dhe "CES" nga Austria. Projekti ende është në fazën e përzgjedhjes së kontraktorëve. Deri më tani ende nuk ka filluar punë konkrete në teren.

Sfidë ka qenë prania e kabllave të KEK, PTK, etj në trasën e termopërquesit dhe prania e drunjëve përgjatë trasës, mirëpo këto probleme janë evituar me kohë.

Vendosja e matësve individual të ngrohjes në secilën banesë (trup ngrohës) - është zgjedhur kompania konsulente "IC Consulente" nga Austria dhe "DECON" nga Gjermania. Ende nuk ka filluar të punohet konkretisht në këtë projekt ende nuk është zgjedhur kompania kontraktuese për realizimin e projektit.

Sfidë - kordinimi me banorët gjatë realizimit të këtij projekti për arsye se matësit duhet të vendosen në hapësirat brenda banesave të tyre.

Objektivi specifik 3.2: Ndërtimi i centralit të gjenerimit të energjisë termike në Ngrohtoren e Qytetit të Gjakovës si dhe përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues për shfrytëzimin maksimal të kapacitetit të ri të parashikuar të gjenerimit të energjisë termike

Ndërtimi i impiantit të ko-gjenerimit nga biomasa (16.5 MWt/1,5MWe) - Në fund të vitit 2018 kanë përfunduar procedurat e përzgjedhjes nga ana e ZBE-së dhe më pastaj janë nënshkruar kontratat përkatëse: Për mbikqyrjen e punimeve EGIS International nga Franca; Për dizajnimin dhe konstruktimin URBAS nga Austria.

Pas sigurimit të të gjitha lejeve dhe dokumenteve të nevojshme, me datën 10.12.2019 është hedhur gurëthemeli i fillimit të punimeve për ndërtimin e Ngrohtores së re.

Sfidë - Vonesat në aprovimin e Autorizimeve dhe Lejeve përkatëse ka bërë që të humbet mjaft kohë e përshtatshme për ndërtim.

Objektivi specifik 3.3: Përgatitja e kushteve për fillimin e ndërtimit të sistemeve të energjisë termike në qytetet të Kosovës (Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Drenas, Obiliq, Mitrovicë dhe Zveçan)

Realizimi i studimit për vlerësimin e mundësive për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese nga energjia termike apo bashkëprodhimi si dhe rritja e kapacitetit prodhues dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes – Ky studim nuk ka filluar ashtu siç është paraparë, sepse nuk janë gjetur mjetet financiare për realizimin e tij.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË GAZIT NATYROR

Objektivi specifik 4.1: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe planifikuese për menaxhimin e aktiviteteve për procesin e zhvillimit të infrastrukturës së gazit natyror

Zbatimi i Marrëveshjes të Mirëkuptimit për Partneritetin e Modelimit të Tubacioneve të Gazit Natyror - Me 1 Tetor 2019 është nënshkruar marrëveshja e rishikuar e bashkepunimit për gazin natyror në Evropën lindore, i mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe realizuar nga Asociacioni i Energjisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USEA), Ministrinë dhe Operatorët e sistemeve të transmisionit të gazit natyror të Evropës Lindore. Ndryshimet e memorandumit fillestart të nënshkruar me datë 16 maj 2017 në Zagreb ishin rreth mbrojtjes së të dhënave të antarëve pjesmarrës pasi grupit EE-NGP iu bashkangjiten edhe Greqia, Polonia dhe Rumania.

Qëllimi i krijimit të këtij partneriteti, është ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme institucionale për zhvillimin dhe shfrytëzimin e modeleve të përbashkëta të planifikimit të transmisionit të gazit natyror. Këto modele do të shfrytëzohen për analizim në baza regjionale të infrastrukturës së brendshme të tubacioneve, interkonjeksioneve, dhe kapaciteteve depozituese regjionale të nevojshme për procesin e gazifikimit në Evropë Lindore.

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur 3 takime të grupit punues për ‘Eastern European Natural Gas Partnership’ (EE-NGP). Takimi i parë për vitin 2019 u mbajt më 27 – 29 Mars 2019 në Athinë, Greqi. Takimi i dytë është mbajtur më datë 18 – 19 Korrik 2019 në Lublanë, Slloveni. Takimi i tretë është mbajtur më datë 11 – 13 Nëntor 2019 në Shkup, Maqedoni.

Qëllimi i takimeve ishte konsolidimi i grupit punues të EE-NGP për përfundimin e studimit ‘Optimizimi i Sistemit Rajonal të Gazit për të arritur koston më të ulët dhe diversifikimin maksimal të furnizimit me gaz për vitin e synuar 2040’ të inicuar nga ana tyre (USEA/USAID) si dhe

vazhdimin e trajnimeve për shfrytëzimin e softuerit ‘Simone’ për krijimin e modelit të përbashkët të transmisionit për Evropën Juglindore.

Studimi i fizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë - Lidhur me këtë aktivitet nuk ka pasur ndonjë zhvillim. Ky aktivitet realizohet në bazë të kërkesave të adresuara nga Pala e Shqipërisë, e cila njëherit është edhe promotor i këtij projekti.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: PLOTËSIMI I CAQEVE DHE DETYRIMET PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË, BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Objektivi specifik 5.1: Zbatimi i planit të tretë të ndërmjetëm 2016- 2018

Programi i zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objektet publike në nivel lokal për arsim dhe shëndetësi – Faza e tretë - Në kuader të Projektit me nr. 213/19/019/521 është financuar vetëm një objekt arsimor në Gjakovë, Shkolla Yll Morina. Për shkak të kontesteve Shkollë-Punekryers, objekti është përfunduar 80 %.

Sfidë - Sfidë në finalizim të projekteve kanë qenë procedurat e prokurimit dhe operimi.

Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrje të tjera te obligueshme – Programi mbështetës - Zbatimi i Masave të Efijencës së Energjisë në Ndërtesat e Shërbimit Publik (II) - Janë zbatuar masat e Efijencës së Energjisë në ndërtesat e shërbimit publik në 19 objekte shkollore.

Fushata promovuese për Efijencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë - Projekti ka përfunduar sipas kërkesave të TeR dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratë.

Objektivi specifik 5.2: Transpozimi i Direktivës Evropiane për Efijencën e Energjisë 2012/27/EC nëpërmjet rishikimit të Ligjit aktual për efijencën e energjisë, si dhe hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të Ligjit të ri për efijencën e energjisë

Rregullorja për themelimin e ESCO - Nuk ka pasur progres, për shkak të ndryshimit/plotësimit të legjislacionit sekondar, i cili duhet të ndryshohet për hartimin e draftit të Rregullores për Themelimin e ESCO.

Sfidë - Është në diskutim formati dhe mënyra, se cilat ligje duhet të amandamentohen.

Hartimi i UA për Auditim të energjisë - Udhëzimi përketes i ka kaluar të gjitha hapat procedural dhe është finalizuar, por ka mbetur pa u nënshkruar nga Ministri.

Sfidë – Ndryshimet e shpeshta në qeverisje shkaktojnë vonesa në miratimin e UA.

Hartimi i UA për etiketimin e pajisjeve elektroshtepiake - Për këtë aktivitet nuk ka pasur ndonjë zhvillim dhe për tu realizuar varet nga zhvillimet pasuese nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë perkatësisht aprovimit Këshillit Ministror.

Objektivi specifik 5.3: Plotësimi i AKEE me stafin e nevojshëm dhe zhvillimi i kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e politikave të Efijencës së Energjisë

Riorganizimi i AKEE – së - Eshte finalizuar rregullorja për Organizmin dhe Sistematizimin e vendeve të punës së Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë AKEE, e cila ka qenë edhe obligim ligjorë nga Ligji për Efijencë të Energjisë Nr. L 06/079.

Përveq kushteve teknike, sallave dhe mungeses së paisjeve Sfida të tjera GP nuk ka pasur.

Skema për themelimin e një sistemi të qëndrueshëm për trajnimin dhe certifikimin e auditorëve të energjisë - Ky aktivitet realizohet dhe arrihet nga AKEE pas miratimit të Draftit final të UA për Auditorë, Certifikues dhe Vlersues të Energjisë (Auditim të Energjisë).

Sfidë- Sfidë mbetet miratimi i legjislacionit sekondar UA për Auditim të Energjisë obligim që varijon nga Ligji për Eficiencë të Energjisë L 06/079 EE neni 23.

Objektivi specifik 5.4: Zhvillimi i Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019 e me tej sipas kërkesave të Direktivës 2012/27/EC dhe një studimi paraprak

Hartimi i Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019-2027 është anuluar ky aktivitet, sepse ka filluar hartimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë PKEK. Aktivitetet e EE-së do të përshtaten duke pasur në konsideratë kërkesat e vendimeve të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë për qasjen e integruar për hartimin e planeve të ardhshme për energji dhe klimë sipas Rregullores së Qeverisjes së Unionit të Energjisë. Sipas kësaj rregulloreje caqet e EE-së përcaktohen për periudhën 2021-2030 dhe mbi këtë baze hartohen dy skenarë: Skenari Referent dhe Skenari i Politikave për arritjen e caqeve të EE-se deri në 2030.

Hartimi i Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për periudhën 2019-2021 – Është hartuar drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë PKVEE IV 2019-2021 dhe është i gatshëm për aprovim në Qeveri pas përfundimit të procedurave të diskutimeve publike dhe aprovimit të fazës fillestare.

Sfidë - Sfidë ka qënë mbledhja e të dhënave dhe procesi i funksionalizimit të Qeverisë.

Objektivi specifik 5.6: Hartimi dhe miratimi i Programit për mobilizimin e investimeve për renovimin e elementeve të ndërtesave rezidenciale dhe komerciale në sektorin publik dhe atë privat, sipas Vendimit të Këshillit Ministror të KE-së

Hartimi i Strategjisë për rinovimin e ndërtesave qeveritare - Është hartuar Drafti i Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe pritet të kalojë në procedurat ligjore administrative, para miratimit.

Sfidë mbetet Hartimi dhe Plotësimi i Legjislacionit Sekondar.

Objektivi specifik 5.7: Zbatimi i masave të EE dhe BRE në ndërtesa publike të nivelit qendror dhe komunal

Përfundimi i projektit të EE - BRE të kredituar nga BB si dhe raportimi – Projekti i financuar nga KfW dhe Qeveria Gjermane është në fazën fillestare. Janë përfunduar procedurat e Prokurimit, është përzgjedhur Kompania e cila do të bëjë Dizajnin dhe Implementimin e Projektit. Është në proces nënshkrimi i kontratës me kompanin e përzgjedhur.

Projekti parashihet zbatimin e masave të EE në 15 ndërtesa të nivelit lokal në Komunitet; Prishtinë, Gjiçan, Ferizaj dhe Gjakovë. Ky projekt mbështetet nga: KfW kredi 2.5 Mil. euro dhe 5 Mil. euro grand WIBF. Parashihet që kontrata të nënshkruhet me konsulencë në mars 2020.

Sfidë - Procedurat e prokurimit kanë zgjatur një vit dhe procesi është realizuar nga KfW.

Objektivi specifik 5.8: Zbatimi i masave për EE, BRE dhe Mjedis, të përcaktuara në Deklaratën e Parisit lidhur me Kartën e Qëndrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor (WB6) Heqja e barrierave ligjore dhe rregullative për EE – Nuk ka pasur zhvillim.

Promovimi i ESCO dhe kontratave të tyre - nuk ka pasur progres dhe Promovimi ndërlidhet me Hartimin e Rregullores për ESCO dhe ndryshimin e legjislacionit.

Sfidë- Rishikimi ndryshimi i pakos së ligjeve të energjisë dhe Ligjit të Prokurimit, Ligjit të Partneritetit Publiko Privat.

Hartimi i programit-udhëzuesit për zbatimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa - Është punuar drafti nga projekti REEP plus dhe është finalizuar pas diskutimeve me grupin teknik punues. Dokumenti është në gjuhën angleze dhe duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe serbe. Pastaj mund të publikohet si dokument final.

Sfidë - Përkthimi profesional dhe teknik nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe serbe, pasi që ky dokument është teknik dhe duhet të përkthehet nga profesionist të fushës.

Programi Multi-Country për vitin 2018-2020 - Projekti: Zhvillimi i sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit të gazrave serrë, trendet historike dhe të projekteve në përputhjen me Rregulloren për mekanizmat e monitorimit Nr. 525/2013 nenet 5, 7, 12 dhe 14 – Sistemi kombëtar për monitorimin dhe raportimin e gazrave serë sipas kërkesave të rregullorës për mekanizmat e raportimit nr. 525/2013, është pjesërisht funksional. Në kuadër të këtij sistemi Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është institucion përgjegjës për koordinimin e monitorimit dhe raportimit të gazrave serë. AMMK bënë raportimin në baza vjetore të gazrave serrë në Agjencin e Mjedisit të Evropës.

Sfidë - Nuk ka zyrtarë të veçantë të punësuar në AMMK për përgatitjen e të dhënave për inventarin e Gazrave serë. Kosova ende nuk e ka të përcaktuar vitin referent për inventarin e gazrave serë. Kosova nuk ka targete për reduktimin e gazrave serë. Kosova nuk është anetare e UNFCC dhe nuk ka obligime raportimi në kuadër të kësaj konvente. Ka mungesë të të dhënave historike për disa sektorë.

Objektivi specifik 5.9: Vazhdimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë 2011- 2020 dhe rishikimi i tij në përputhje me kërkesat e direktivës së BRE-ve

Vlerësimi i PKVBRE 2011-2020 - Raporti i arritjes së pjesëmarrjes së BRE për vitin 2018 është bërë në fillim të vitit 2019 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në Eurostat në kaudër të formatit Share tools. Arritja e caktuar ka qenë 24.9 % në bruto konsumin final të energjisë. Duke pas parasysh që raporti i progresit për BRE realizohet çdo dy vite atëherë në vitin 2020 do të hartohet për vitet 2018-2019, ndërsa raportimi për Eurostat behet çdo vite.

Rishikimi i planit të veprimit për BRE 2011- 2020 - Plani i rishikuar është dërguar në kabinetin e Ministrisë në muajin shkurt të 2019. Pas dorzimit të mandatit nga Ministri, plani është kthyer i pa nënshkruar dhe pa ndonjë arsyetim.

Sqarim - Meqenëse caku që e përmban PKVBRE 2011-2020 pothuajse është arritur, atëherë nuk kemi nevojë që të miratohet rishikimi i këtij plani.

Plotësimi i caqeve të energjisë nga BRE përmes zbatimit të projekteve konkrete :

Hidocentrale	7 Projekte, 29.76 MW
Turbina nga Era	1 Projekt, 32.4 MW
Panele solare	2 Projekte, 3.4 MW

Sfidë - Si mund të shihet, realizimi i projekteve të parapara për vitin 2019 është rreth 70% duke patur parasysh që KITKA (Turbinat nga Era) është përfunduar para kohe, që i bie në muajin tetor të vitit 2018.

Si penges për realizimin e parashikimeve janë paraqitur vonesat në disa Hidrocentrale, të cilat ndërlihen me aspekte teknike të realizimit. Këto pritet të finalizohen në gjashtëmuajorin e parë të 2020.

Aplikimi i skemave mbështetëse të përshtatshme për tërheqjen e investimeve në BRE (Fidin tarifa ose fidin – Premium) – ZRRE deri më tani ka aplikuar tarifën "feed-in" për mbështetjen e projekteve për ndërtimin e gjeneratorëve të ri nga BRE-të. Kjo mënyrë e përkrahjes kërkohet të zëvendësohet sa me shpejtë që të jetë e mundur me instrumente konkurruese Ankaand /Tender. Është ende e paqartë se këtë proces a do e menagjojë ZRRE apo MEA andaj kjo mbetet të sqarohet mes këtyre dy institucioneve. Kushdo që caktohet ta menagjojë këtë proces do jetë e domosdoshme hartimi i Procedurave për udhëheqjen e tij.

Sfidë - Kalimi prej tarifës nxitëse në skemat konkurruese.

Thjeshtësimi i procedurave të autorizimit për projektet e BRE-ve dhe harmonizimi i afateve ligjore të pëlqimeve dhe lejeve tënevojshme në përputhje edhe me jetëgjatësinë e teknologjive - Nuk ka zhvillime

Sfidë: Si sfidë mund të konsiderohet kalimi prej tarifës nxitëse në skemat konkurruese. Reformat në legjislacionin primar dhe sekondar janë parakusht për ndërtimin e skemave mbështetëse për kapacitetet e reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme.

Objektivi specifik 5.10: Mbështetja e projekteve të gjenerimit për sistemet e energjisë termike që shfrytëzojnë BRE-të si lëndë djegëse si dhe nxitja e zhvillimit të tregut të biomasës drusore, duke marrë parasysh format e përdorimit të saj siç janë peleti dhe briketi

Shqyrtimi i mundësive për ndërtimin e skemës mbështetëse për gjeneruesit e energjisë termike nga BRE - Nuk ka ndonjë zhvillim sa i përket këtij aktiviteti.

Skema stimuluese për konsumatorët e peletit dhe briketit - Nuk ka ndonjë zhvillim sa përket këtij aktiviteti.

Objektivi specifik 5.11: Funksionalizimi i One Stop Shop-it për BRE-të

Hartimi i manualit/udhëzuesit për funksionalizim të One Stop Shop-it për BRE dhe përshkrimi i detyrave të punës për stafin, i cili do të angazhohet në One Stop Shop – Është formuar Komisioni Koordinues Ndërinstitucional për zhvillimin e bashkëpunimit për One Stop Shop për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Është mbajtur takimi i parë i Komisionit Koordinues Ndërinstitucional për zhvillimin e bashkëpunimit për One Stop Shop për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Është hartuar Doracaku i Procedurave, nga kompania REPOWER.

Objektivi specifik 5.12: Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit me acquis të BE-së për aspektet mjedisore të aktiviteteve energjetike dhe zbatimi i tyre sipas dinamikës së parapare për periudhën 2018- 2027

Hartimi i projekt Ligjit për PKIN - Ligji I PKIN - Është në fazën e draftimit duke e transpozuar Direktiven 2010/75/EU.

Sfidë - Gjatë draftimit të Ligjit për PKIN nga anëtarët e grupit punues ka dal kërkesa për asistencë teknike nga TAIEX për draftimim e mëtuqjeshem të Ligjit.

Hartimi i Koncept Dokumentit dhe Ligjit të ri për VNM - Është përfunduar Koncept Dokumenti i Ligjit për VNM, ndërsa Ligji i VNM është në fazën e draftimit duke u transpozuar Direktiva 2014/52/EU.

Objektivi specifik 5.13: Dekomisionimi dhe çmontimi i objekteve të gazifikimit, azotikut, ngrohtores dhe objekteve tjera që nuk e pengojnë operimin normal të njërive aktive të TC “Kosova A”

Përgatitja e Studimit për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social si dhe dokumenteve tjera të nevojshme për dekomisionimin e objekteve të gazifikimit, azotikut dhe ngrohtores në

lokacionin e TC “Kosova A”, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për punët e çmontimit të objekteve që do t’i nënshtrohen dekomisionimit – Projekti është duke u realizuar sipas Termave të Referencës nga kompania konsulente Sweco Gmb. e cila ka filluar punën në muajin korrik 2018 dhe pritet të përfundojë në muajin gusht 2020. Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë identifikuar të gjitha objektet që do të dekomisionohen dhe është përgatitur harta e cila përfshin të gjitha objektet që pritet të çmontohen.
 - Janë bërë hulumtime të terrenit nëse ka ndotje të dheut dhe ujërave nëntokësorë
 - Legjislacioni aktual është analizuar dhe një raport i detajuar mbi kornizën ekzistuese ligjore është hartuar me rekomandime.
 - Është përgatitur një Udhëzues për procedurat ligjore për marrjen e të gjitha lejeve të nevojshme për procesin e dekomisionimit dhe janë identifikuar dokumentet që duhet të përgatiten për marrjen e këtyre lejeve.
 - Sa i përket Studimit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social janë zhvilluar konsultime me departamentin e mjedisit në Komunë të Obiliqit, departamentin e KEK për dekomisionim dhe konsultime publike me qytetarët e komunës së Obiliqit. Pas përfundimit të konsultimeve është përgatitur drafti i studimit dhe pritet që të finalizohet në fillim të muajit korrik 2020.
 - Është përgatitur një bazë e të dhënave për të gjitha materialet e pranishme në objektet që pritet të dekomisionohen.
 - Për magazinimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme që pritet të dalin nga procesi i çmontimit të objekteve, pritet të përdoret objekti i Hangarit (objekt në zonën e planifikuar për dekomisionim). Tashmë, është bërë një vlerësim lidhur me stabilitetin strukturor të objektit të Hangarit. Mendimi i ekspertit është se përdorimi i këtij objekti është i mundshëm, por duhet të bëhen rinovime për të përmbushur kërkesat në lidhje me depozitimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme. Gjithashtu, një zonë përreth hangarit do të jetë në dispozicion të depozitimit të përkohshëm të mbeturinave jo të rrezikshme.
 - Procesi i përgatitjes së dokumentacionit të tender dosjes në lidhje me çmontimin e objekteve ka filluar. Procesi i çmontimit pritet të mbështetet me Programin IPA 2019.
- Sfidë - Anulimi për ndërtimin e magazinave për magazinimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë. Si pasojë është duke u trajtuar alternativa për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të rrezikshme që dalin nga dekomisionimi, në lokacionin e TC “Kosova A” (objekti i hangarit).

AKTIVITETE TË TJERA

Studimi i Fizibilitetit dhe VNMS për Gazsjellësin Maqedoni Veriore – Kosovë - Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Ministria e Zhvillimit Ekonomik i Republikës së Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë së Maqedonisë së Veriut, në shkurt të vitit 2019, kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit mes dy vendeve në sektorin e energjisë duke përfshirë edhe sektorin e gazit natyror. Në zbatim të kësaj marrëveshje, në fillim të vitit 2019, një aplikim i përbashkët me Maqedoninë e Veriut, kjo e fundit si promotor i projektit, është dorëzuar në WBIF, për mbështetje financiare në formën e një granti për realizimin e një studimi të fizibilitetit dhe VNMS për interkoneksionin Maqedoni Veriore - Kosovë. Komiteti Drejtues i Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) ka aprovuar grantin dhe ka angazhuar konsulentin IFICO është angazhuar për përgatitjen e termave të referencës.

Përgaditja e Master Planit për Gaz Natyror në Kosovë - Sipas rekomandimeve të Studimit të parafizibilitetit për Gazsjellësin Shqipëri - Kosovë (Projekti ALKOGAP) ish MZHE tani MEA në bashkëpunim me grupet e tjera të interesit në fillim të vitit 2019 përmes platformës WBIF ka aplikuar për ndihmë financiare në formë granti për përgatitjen e Master Planit për shpërndarjen dhe furnizimin e gazit natyror në Kosovë. Komiteti Drejtues i Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), sipas njoftimeve nga MIE, në qershor të vitit 2019 në Berlin ka darkorduar një grant prej 1.5 milion Euro për përgatitjen Master Planit. Aktivitet që realizohet përmes kërkesave që adresohen përmes platformës WBIF.

Studimi i parafizibilitetit për gazifikimin e Kosovës nga MCC - Bazuar në iniciativën e Millenium Challenge Corporation (MCC), është duke u realizuar një studim i parafizibilitetit për gazifikimin e Kosovës nga konsulentët e angazhuar nga MCC. Një draft i kornizës së punës (scope of work) është përfunduar si dhe termat e referencës të përgaditura nga konsulentët e angazhuar nga MCC janë aprovuar. Sipas njoftimeve nga MCC, rezultatet paraprake priten të jenë të gatshme në pjesën e parë të vitit 2020, të cilat do të shërbejnë si mbështetje për përgaditjen e Master Planin për gazin natyror për Kosovën dhe Studimin e Fizibilitetit për interkoneksionin në Maqedoni Veriore - Kosovë.

Hartimi i Udhëzuesit për zbatimin e Kërkesave Minimale për Përformancën Energjetike në Ndërtesat Ekzistuese në Sektori Rezidencial – Tipologjia dhe Përformanca Energjetike e Ndërtesave të Banimit në Republikën e Kosovës - Nga projekti KEEP - GIZ dhe ekspert lokal në koordinim edhe me grupet punuese është hartuar drafti final i këtij udhëzuesi. Dokument pritet të finalizohet dhe të publikohet deri në mesin e këtij viti për zbatimin e rregullores për zbatimin e Kërkesave Minimale për Përformancën Energjetike në Ndërtesat Ekzistuese në Sektori Rezidencial.

III. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Rreziqet

Duke ditur që sektori i energjisë është mjaft kompleks dhe varet nga shumë faktorë të cilët ndikojnë në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e tij, atëherë për realizimin e të gjitha objektivave të Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026, si dhe PZSE 2018-2020, duke pasur në konsideratë zhvillimet rreth zbatimit të politikave, masave dhe aktiviteteve të deritashme mundtë evidentohen rreziqe në mbarëvajtjen e projekteve kyçe që përcaktojnë sigurinë e furnizimit. Rreziqet e identifikuar konisderohen si në vijim:

- Mosrealizimi i projekteve si pasojë e pamundësisë së gjetjes së financave;
- Mosmarrja e vendimeve në kohë për gjetjen a alternativave të sigurimit të furnizimit afatgjatë me energji;
- Pengesa nga komuniteti gjatë shpronësimeve me rastin e zhvillimit të minierës ekzistuese dhe asaj të re;
- Mosarritja a caqeve për uljen e humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e distribucionit të energjisë elektrike, të përcaktuara nga Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026 si dhe Planit Investiv 5 vjeçar të KEDS-it, të aprovuar nga ZRRE;
- Ndërrimet e shpeshta të qeverive.

Hapat për adresimin e rreziqeve

Bazuar në rreziqet të renditura më lartë, në vijim adresohen orientimet për shmangien e rreziqeve me qëllim të krijimit të kushteve për realizimin e objektivave strategjike.

- Ndërmarrja e shpejt e masave për gjetjen e alternativave të furnizimit afatgjatë të besueshemëm me energji elektrike bazuar në zhvillimet e fundit rreth projektit TC Kosova e Re:
 - zhvillimin e një studimi të fizibilitetit për rehabilitim/modernizim të blloqeve të TC Kosova A;
 - rishikimi i projektit TC Kosova e Re duke marrë në konsideratë problemet e shfaqura përgjatë procesit;
 - përsheptimin e hapave në studimin e fizibilitetit për zhvillimin e sistemit të gazit natyror në Kosovë;
 - krahas studimit të mundësisë së zhvillimit të sistemit të gazit natyror të përshejtohet studimi i termofikimit me sistemin e ngrohjes qendrore të së paku qyteteve të mëdha të Kosovës;
 - të adresohet çështja e dekarbonizimit në dritën e sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike.
- Të rritet komunikimi me komunitetin lokal dhe azhuriteti i institucioneve në parandalimin e ndërtimeve për qëllime përfitimi gjatë shpronësimit të pronave në lokacionin ku zhvillohet

miniera ekzistuese dhe ajo e re;

- Të bëhen investime në rrjetin e distribucionit të energjisë elektrike me qëllim të arritjes së caqeve për uljen e humbjeve teknike dhe atyre komerciale. Në veçanti të ndërmerren veprime për të mundësuar kompanive të shpërndarjes dhe furnizimit me energji të operojnë të papenguar në komunat në veri të Kosovës me qëllim eliminimin e problemeve që shkaktohen nga mospagesa e energjisë së dërguar në to komuna;
- Të ndërmerren masa për rishikimin e skemave mbështetëse për promovimin e investimeve në fushën e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të në baza konkurruese duke pasur parasysh praktikën e BE-së;
- Të zhvillohen politika dhe masa të reja për rritjen e efikasitetit të energjisë;
- Bashkëpunim më i ngushtë me institucionet ndërkombëtare financiare.

I. SHTOJCA - PJESA MATRICORE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2018 TË PZSE 2018-2020

Të gjitha të dhënat e përgatitura janë të paraqitura në tabelat e mëposhtme, janë të renditura në bazë të PZSEK 2018-2020.

Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	Progresi në zbatim
I.	SIGURIMI I FURNIZIMIT TË QËNDRUESHËM DHE CILËSOR ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE ME KAPACITETET TË NEVOJSHME PËR NJË SISTEM STABIL ELEKTROENERGJETIK						
I.1	TC Kosova e Re						
I.1.1	Arritja e përmbushjes financiare me Countur Global	TM4 2017 TM1 2019	BRK	NTCKR/ Ish MZHE	Përmbyllja financiare e projektit e arritur	PZSE 2018-2020	Nuk mund të shprehet në përqindje Në përputhje me marrëveshjet komerciale për ndërtimin e TC 'Kosova e Re', gjatë kësaj faze raportuese nuk ka ndodhur përmbyllja financiare.
I.1.2	Hartimi i TeR, tenderimi dhe kontraktimi i inxhinierëve të pavarur	TM1 2018 TM4 2019	BRK	KDP/ NJIP	TeR të hartuara dhe kontraktimi i inxhinierëve	PZSE 2018-2020	70% Është përfunduar faza e pare e tenderimit dhe janë parakualifikuar 3 kompani. Momentalisht procesi është në fazën e vlerësimit të ofertave.
I.1.3	Plotësimi me staf përkatës i Njesisë Implementuese të Projektit sipas vendimit të KDP-së	TM1 2018 TM4 2019	BRK	KDP/ NJIP	NJIP e plotësuar me staf		0% Nuk ka progres sa i përket kësaj qeshtje. Është e rëndësishme që në përputhje me vendimin e KDP-së të plotësohen të gjitha pozitat.
I.1.4	Pjesëmarrja/realizimi i konferencave informuese për mundësin e përfshirjes së NVM-ve në projektet zhvillimore energjetike: a) Pjesëmarrja e ish MZHE në Konferencën informuese “Ditët e biznesit të vogël” të cilën e organizon MTI për sektorin e NVM-ve – Tema nga ish MZHE: “Informimi i NVM-ve për	a) TM3 2018 b) TM2 2019	Ish MZHE / MTI	Ish MZHE / MTI	Informimi i NVM-ve për mundësitë e përfshirjes së tyre në projektin e TC Kosova e Re		0% Duke pasur parasysh zhvillimet në lidhje me TC Kosovës së Re, atëherë ky aktivitet nuk është realizuar.

	mundësitë e përfshirjes së tyre gjatë procesit ndërtimit të TC Kosova e Re” b) Realizimi i konferencës me temën “Investimet strategjike në sektorin e energjisë – Mundësitë e përfshirjes dhe participimi aktiv i NVM-ve në këto projekte”						
I.2	Realizimi i remonteve kapitale në TC Kosova A, TC Kosova B dhe instalimi i elektrofiltrave në TC Kosova B						
I.2.1	Remonti kapital i Njesisë A3 të TC Kosova A	TM2 - TM3 2018	KEK	KEK	Remonti kapital i Njesisë A3 të TC Kosova A i realizuar	PZSE 2018-2020	100%
I.2.2	Remonti kapital i Njësia B2 të TC Kosova B	TM2 – TM3 2018	KEK	KEK	Remonti kapital i Njesisë B2 të TC Kosova B i realizuar		100%
I.3	Mihja e Re “Sibovci Jugor”						
I.3.1	Përgatitja e planit të detajuar për hapjen e mihjes së re	TM3 2017 TM2 2018	KEK	KEK	Dokumenti final i planit të detajuar	PZSE 2018-2020	100%
I.3.2	Hapja e mihjes së re	TM2 2019 TM1 2023	Qeveria e Kosovës	Ish MZHE/ KEK	Mihja e re e gatshme për eksploatim	PZSE 2018-2020	0% KEK-u në qershor 2019 ka shpallur tenderin për sigurimin e dy eskavatorëve i cili është në proces, mirpo investimet të nevojshme për minierën e re nuk mund të realizohen pa përkrahjen e Qeverisë së Kosovës. Sipas dokumentit plani i detajuar dhe investiv për minierën e re investimet e nevojshme janë 380 milion euro (295 milion euro në 5 vitet e para).
I.4	Reduktimi i humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes Reduktimi i humbjeve teknike deri ne 9.5% deri në vitin 2026 në rrjetin e shpërndarjes						
I.4.1	Ndërrimi i njësoreve mekanik me njehsorë digjital	TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm	KEDS	KEDS	Reduktimi dhe parandalimi i humbjeve komerciale; Eliminimi i gabimeve të mundshme në lexim;	PZSE 2018-2020	100% Janë realizuar këto investime:
I.4.2	Zhvendosja e njehsorëve (MMO)						2,922 Njehsorë inteligjente me komunikim GSM GPRS 1,8078 njehsore ineligjent PLC

<p>I.4.3</p>	<p>Implementimi i njehsorëve automatik inteligjent; Për vitet 2018-2020 numri i pritshëm për ndërrimin e njehsorëve arrin rreth 161 247** mijë njehsorë</p>	<p>vitet 2018-2020)</p>			<p>Zvogëlim i mundësisë së keqpërdorimit të njehsorëve</p>		<p>196 njehsorë gjysëm-indirekt 10,039 njehsorë mekanikë janë zëvendësuar me ata elektronik 25,972 njehsorë janë vendosur për kyçje të reja</p>						
<p>I.4.4</p>	<p>Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes duke u fokusuar në kalimin në nivel të tensionit 20 kV, respektivisht eliminimin gradual të tensionit 35 kV dhe 10 kV, në përputhshmëri me rregullat e ZRRE-së dhe standardet ndërkombëtare</p>	<p>TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)</p>	<p>KEDS</p>	<p>KEDS</p>	<p>Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe rënieve të tensionit; Furnizimi i pandërprere me energji elektrike dhe rritja e cilësisë së furnizimit; Lokalizimi i prishjeve</p>	<p>PZSE 2018-2020</p>	<p>100% Në vitin 2019, projektet e tensionit të mesëm u drejtuan në zonat më kritike si Ferizaji, Fushe Kosova dhe Dragashi për të zgjidhur problemet e rritjes së shpejtë të konsumit, mbingarkesës së rrjetit dhe përmirësimit të parametrave të tjerë teknikë. Ndër projektet më të mëdha të energjizuara gjatë vitit 2019 (të cilat projekte kanë filluar implementimin nga vitet e mëparshme janë): projekti i Breznices, Drenices, Runiku dhe Fushë- Kosova. Materialet e vendosura për këto projekte janë: 13 transformatorë, 21 kthina, 18,000 m përçus, 35,320 m kablo, koka kablovike 267 copë, 10 shtylla etj. Në projektin e Fushë-Kosovës është përfshirë edhe renovimi i nën-stacioneve ekzistuese dhe ndërtimi i një nënstationi të ri.</p>						
<p>I.4.5</p>	<p>Zvogëlimi i linjave të gjata radiale duke vendosur stabilimente shpërndarëse nëpër degëzime të daljeve 10kV</p>												
<p>I.4.6</p>	<p>Ndërtimi i nënstationeve të reja të rrjetit të TM/TU;</p>	<p>TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)</p>	<p>KEDS</p>	<p>KEDS</p>	<p>Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale; Zvogëlimi i rënieve të tensionit; Furnizimi i pandërprere me energji elektrike dhe rritja e cilësisë së furnizimit; Zvogëlimi i mbingarkesave; Rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit të shpërndarjes</p>	<p>PZSE 2018-2020</p>	<p>71.94% Projektet e realizuara gjatë vitit 2019 përfshijnë investimet si: Transformatorë të rinj në zonat e nevojshme për investime, Zëvendësimi i transformatorëve ekzistues me ata të ri për rritjen e kapacitetit, Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët, Përforcimi i rrjetit të tensionit të mesëm brenda fushëveprimit të projekteve të TU, në përputhje me planet e ardhshme të daljeve të TM, Zgjerimi i rrjetit të TM për kyçjen e transformatorëve të ri, Vendosja e MMO-ve (lëvizja e njehsorëve jashtë në shtyllë ose në ormana tokësorë të njehsorëve), etj. Më poshtë do të paraqesim materialet e përodura për grupet e projekteve sipas renditje numerike: Për projektet numer 6 janë vendosur 48 transformatorë dhe 48 panele të TU</p>						
<p>I.4.7</p>	<p>Ndërtimi i rrjetit të ri të tensionit të ultë;</p>												
<p>I.4.8</p>	<p>Rehabilitimi i rrjetit ekzistues;</p>												
<p>I.4.9</p>	<p>Furnizimi alternativ i daljeve 10kV, gjegjësisht nënstationeve ekzistuese nga ana sekondare; Në kuadër të këtij aktiviteti, gjatë viteve 2017- 2019, pritet të vendosen dhe/apo zëvendësohen rreth 200 transformatorë për vit</p>												

							<p>Për projektet numer 7 janë vendosur 461 shtylla, 272 kuti të njehsoreve dhe 21,408 m kablllo (linja) Për projektet numer 8 janë vendosur 45 transformatorë, 73 panele të TU, shtylla 6,595 copë, kuti të njehsorëve 8,298, rreth 900,000 m kablllo, respektivisht 388,439 m kablllo nëntokësore dhe 508,996 m kablllo mbitolokësore, etj.</p>
I.4.10	Implementimi i sistemit SCADA për kontrollin, komunikimin dhe mbikëqyrjen e te dhënave;	TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)	KEDS	KEDS	Zvogëlimi i orëve të ndërprera të paplanifikuara dhe izolimi i ndërprerjeve; Modernizimi i rrjetit; Qasja e lehtë në të dhënat energjetike të sistemit të shpërndarjes; Rritja e cilësisë operative		100% Ky projekt është implementuar sipas planifikimeve dhe pritet që të përfundojë faza III dhe faza e fundit e projektit Scada deri në fund të vitit 2020.
I.4.11	Implementimi i softuerëve për kalimin nga rrjeti i vjetër në rrjetin e mençur						93.97%
I.4.12	Implementimin e kërkesave të reja me hapjen e tregut konkurrues; Plotësimi i nevojave për makineri dhe mjete të punës, me qëllim të lehtësimit të operimit dhe shkurtimeve të kohës së reagimit ndaj prishjeve						
I.5	Reforma Programore Universitare në shkencat teknike të fushë veprimtarisë së energjisë						
I.5.1	Zhvillimi i programeve dhe praktikave të reja mësimore, konform kërkesave të reja të tregut të punës për inxhinierët e rinj, bazuar në modelet më të mira në vendet e BE-së	TM3 2018 TM4 2020	Donatorët	UP FIEK FIM	Programi i ri në përputhje me kërkesat e reja të tregut të energjisë	PZSE 2018-2020	<p>FIEK:100%</p> <p>FIM: 72%-Bachelor; 90%-Master FIM deri me 30.09.2021 e ka të akredituar Programin studimor "Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtërishme" i cili është bazuar në praktikat më të mira të BE-es dhe nevojave të tregut të punës në Kosovës. Tani FIM-i është në proces të pergaditjes së Raportit të Vetëvlersimit për Ri-akreditimin e këtij programi dukë</p>

						planifikuar ndryshim të kurrikulave në masë prej 20% aq sa është e lejuar gjithnjë duke ju përshtatur sa më të mirë të tregut të punës. Në këtë program studimi në nivelin Bachelor janë pranuar 65 studentë ndërsa në nivelin Master janë pranuar 18 studentë të rregullt.
I.5.2	Mbështetja me bursa për studentët e dalluar që ndjekin studime në ato programe në Fakultetin i Inxhinierës Elektrike dhe kompjuterike - drejtimi i Elektronergjetikes: niveli Bachelor, Master dhe Doktoratur	TM3 2019 TM4 2021	Donatorët BRK	UP FIEK	Mbështetje financiare për 20 student të Bachelor, 20 student të master dhe 10 në studime të doktoraturës të drejtimin të elektroenergjetikës	0% Nuk ka pasur mbështetje financiare për 20 studentë të nivelit bachelor gjatë vitit 2019. Po ashtu nuk ka pasur mbështetje financiare as për 20 studentë të nivelit master, respektivisht 10 studentë të nivelit të doktoratës, edhe pse niveli master dhe ai i doktoratës për drejtimin e Elektroenergjetikës nuk është i akredituar.
I.5.3	Përkrahja e Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA", Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe atë të Inxhinierisë Elektrike dhe kompjuterike: a) Përkrahja në kompletimin e laboratorit në fushën e Termoenergjetikës dhe Energjisë së Ripërtërishme; Realizimi i pilot projekteve në fushën e BRE-ve (instalimi i PV, ngritja e parkut të gjelbër, promovimi i një objekti model me konsum të ulët të energjisë) b) Përkrahja në kompletimin e laboratorëve në drejtimin e elektroenergjetikës	TM3 2018 TM4-2019	Donatorët (TIKA, GIZ, Zyra e BE-së, USAID-i – EMPOWER, MCC, BRK, etj.)	FIM FIEK	Laboratorët e kompletuar me pajisjet e nevojshme për FIM dhe FIEK	FIEK: Nuk mund të shprehet në përqindje Pajisjet e sjellura në laboratorët e Elektroenergjetikës janë: "Primary Injection Test equipment up to 2,500A., with auxiliary ac and dc outputs" me të gjitha pajisjet përcjellëse; "Transmission line model 150km/300km (93.2miles/186.4miles)" me të gjitha pajisjet përcjellëse dhe "Double busbar unit, three-phase, incoming / outgoing feeder", me të gjitha pajisjet përcjellëse. Pajisjet e cekura në fjalë janë vetëm një pjesë e pajisjeve që duhen për të kompletuar laboratorët e Elektroenergjetikës. FIM:40% Nuk janë siguruar fondet për kompletimin e laboratorëve të Energjisë Termike dhe të Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme. Tani është faza finale e renovimit të hapësirave të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP-që finanohet nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në kuadër të këtij projekti është paraparë ujitja e parkut të gjelbër me energji solare. Komuna e Prishtinës po ka përkrahur projektin e FIM-it me instalimin e 8 trupave ndriçues hibrid me energji të erës/diellit. Në objektin e Laboratorëve nga FIM-i është ngritur një Laborator i BER ku janë të vendosura

